



Akti i themelimit

i

"Media '99 SH.A.

Ne të nënshkruarit: 1. Nikolle Lesi, i biri I Palit, i datelindjes 06/08/1963, lindur ne Lezhe, banues ne Tirane me numer pasaporte 0014244
2. Natalina Ucaj, I datelindjes 18/03/1965, lindur ne Lezhe, banuese ne Tirane me numer leternjoftimi 071028
3. Leonard Filopati, I datelindjes 14/11/1975, lindur ne Rreshen, banues ne Tirane me numer pasaporte 0943745
aksionere te shoqerise anonime "Media '99"

(më poshtë referuar si "Aksionerët Themelues")
në përputhje me ligjin nr.7638, dt.19/11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" si dhe ligjin nr.8410, dt.30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat në RSH", biem dakord të themelojmë një shoqëri anonime pa ofertë publike emërtimi i së cilës është "Media '99" SH.A. me anë të nënshkrimit të këtij Akti Themelimi.

Neni 1

Shoqëria "Media '99 Sha" (më poshtë referuar si "media '99") është shoqëri anonime pa ofertë publike, selia e secilës është në Tiranë, Shqipëri me adresë: Rr. "Sami Frashëri" Pallatet e Aviacionit, nr.4.

Afati i veprimtarisë së "Media '99" është 100 vjet.

Veprimtaria e "media '99" rregullohet nga Statuti që i bashkangjitet këtij Akti Themelimi i cili është plotësisht dhe tërësisht i pranuar dhe nënshkruar prej tre aksionerëve.

Neni 2

Objekti i "Media '99" Objekti i "Media '99" është si më poshtë:
Veprimtaria radiotelevizive private kombëtare dhe lokale ku përfshihen prodhimi, transmetimi, ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablllove përsëritësve, satelitëve apo çdo lloj

Nikolle Lesi
Natalina Ucaj

Leonard Filopati

Leonard Filopati
Ljef

mjeti tjetër. Gjithashtu në përputhje me legjislacionin në fuqi "Media '99" do të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të lidhur drejtpërsëdrejti, ose tërthorazi me objektivat e parashikuara më sipër në të gjithë territorin e PSH.

Neni 3

Kapitali fillestari "Media '99" është 2.000.000 lekë (dymilion) dhe numri i aksioneve të autorizuar në të cilën do të ndahet ky kapital është 2.000 (dymijë aksione me një vlerë nominale prej 1.000 (njëmijë) lekë për aksion. Gjithë kapitali aksioner i "media '99" që ndahet në aksione i perket aksionerëve themelues. Fillimi i kapitalit aksioner është kapitali fillestar i paguar nga "Media '99" prej 2.000.000 lekë (dymilion) dhe paguhet prej aksionerëve themelues i ndarë si më poshtë:

- 1-Nikolle Lesi 800 (teteqind) aksione ekuivalente të 40 % të kapitalit të Media "99" të paguara në leke
- 2-Natalina Ucaj 800 (teteqind) aksione ekuivalente të 40 % të kapitalit të Media "99" të paguara në leke.
- 3-Leonard Filopati 400 (katerqind) aksione ekuivalente të 20 % të kapitalit të "Media '99" të paguara në leke.

Kapitali është i derdhur teresisht

Neni 4

"Media '99" SH.A. drejtohet nga Drejtoria e cila përbëhet nga një drejtorë që caktohet nga Këshilli Mbikqyrës për katër vjet me të drejtë rizgjedhjeje. Kompetencat e Drejtorisë parashikohen në statusin e "Media '99". Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë është Enton Abilekaj

Neni 5

Organi Mbikqyrës i "Media '99" është Këshilli Mbikqyrës. Kompetencat e tij parashikohen në statutin e "Media '99". Në përputhje me nenin 93 të Ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" për periudhën e parë katërvjeçare anëtarë të Këshillit Mbikqyrës janë të caktuar në statutin e "Media '99". Anëtarët e këtij Këshilli janë



- Kico Blushi
- Aleksander Cipa
- Natalina Ucaj

Eksperti kontabel i Autorizuar është Luan Kamberi

Neni 6

Viti i parë financiar fillon në datën e rregjistrimit të "Media '99" në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës të Rrethit Tiranë dhe përfundon më 31.12.1999.

Neni 7



Leonard Filopati


Palët e bazojnë marrëdhëniet e tyre lidhur me këtë Akt Themelimi në parimet e dëshirës së mirë dhe mirëbesimit.

Çdo mosmarrëveshje e lindur në lidhje me këtë Akt Themelimi ose statutin e "Media '99", së pari do të provohet të zgjidhet me bisedime midis palëve. Në se problemi nuk zgjidhet miqësisht atëhere çdo mosmarrëveshje, moskuptim ose ankesë e lindur ose e lidhur me këtë Akt Themelimi dhe statut, apo çdo shkelje, zgjidhje apo çdo pavlefshmëri e saj do të zgjidhet në përputhje me Rregullat e Arbitrimit në fuqi. Palët bien dakord për këto edhe për këto rregulla si më poshtë:

Gjatë procesit të krijimit të kolegjit të arbitrave palët mund të ndërmarrin të gjitha veprimet me qëllim që të sigurojnë të drejtat e tyre përpara Gjykatës së Rrethit Tiranë. Gjykata do të vendosë në bazë të legjislacionit shqiptar dhe vendimet e saj do të jenë të vlefshme dhe të detyrueshme. Komisioni kolegjial i arbitrave do të formohet formalisht dhe do të vendosë të konfirmojë, ndryshojë ose revokojë vendime të tilla.

Ligj i zbatueshëm do të jetë ai i Shqipërisë. Vendi i arbitrimit do të jetë Tirana Shqipëri. Gjuha e përdorur në procedurat e arbitrimit do të jetë shqip.

Ky akt themelimi është përgatitur në gjuhën shqipe në katër kopje dhe është nënshkruar personalisht prej aksionerëve themelues sot më datë 05.07.1999

Themeluesit e shoqërisë

1. **Nikoll Lesi**

2. **Natalina Ucaj**

3. **Leonard Filopati**

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

NR 3148 REP

NR 236 KOL

Tirane me 15 maj 2000

V E R T E T I M

Sot me dt 15 maj 2000 para meje noteres Manushaqe Sharke me zyre perballe gjykates rrethit Tirane, rruga Zhan Dark u paraqiten kerkuesit :

Nikolle Lesi i paisur me pasaporten nr 0014244.

Natelina Ucaj e paisur me leter njoftimih nr 071028

Leonard Filopati i paisur me pasaporten nr 0943745.

Te tre madhor dhe me zotesi juridike te plotepar te vepruar.


Ata kerkuen te vertetojne faktin se nenshkrimet e hedhura

ne dokumentacionin e shoqerise "MEDIA" 99" sh.a, jane te tyret

Konform nenit 55 te Ligjit "Mbi Noterine", une noterja i

vertetoj eto.

N O T E R E





STATUTI

I

Shoqërisë anonime pa ofertë publike

"Media '99" Sh.A.

Neni 1-

Emërtimi dhe statusi ligjor

Shoqëria "Media '99" është një shoqëri anonime pa ofertë publike e krijuar në përputhje me ligjin nr.7639 dt. 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" si dhe ligjin nr.8410 dt.30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat në RSH".

Aksionerët themelues janë: **1. Nikolle Lesi, i biri i Palit, i datelindjes 06/08/1963, lindur ne Lezhe, banues ne Tirane me numer pasaporte 0014244**

2. Natalina Ucaj, i datelindjes 18/03/1965, lindur ne Lezhe, banuese ne Tirane me numer leternjoftimi 071028

3. Leonard Filopati, i datelindjes 14/11/1975, lindur ne Rreshen, banues ne Tirane me numer pasaporte 0943745

Neni 2-

Selia

Selia e "Media '99" sha është në Tiranë, Shqipëri. Adresa zyrtare e "Media '99" është : Rr. "Sami Frashëri" Pallatet e Aviacionit nr.4 TIRANE

Neni 3-

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së "Media '99" sh.a është 100 vjet.

Neni 4-

objekti

Objekti i "Media '99" sh.a është: Veprimtaria radiotelevizive private kombëtare dhe lokale ku përfshihen prodhimi, transmetimi, ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë

të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit të destinuar për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kabllove përsëritësve, satelitëve apo çdo lloj mjeti tjetër. Gjithashtu në përputhje me legjislacionin në fuqi "Media '99" do të zhvillojë çdo aktivitet

Leonard Filopati
L.F.

tjetër të lidhur drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me objektivat e parashikuara më sipër në të gjithë territorin e RSH.

Neni 5- Degët

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj "Media '99" sh.a. mund të hapë edhe degë të tjera dhe zyra përfaqësimi si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 6- Kapitali

Kapitali fillestar i "Media '99" sh.a. është 2000.000 (dymilion) lekë dhe numri i aksioneve të autorizuara në të cilën do të ndahet ky kapital është 2000 (dymijë) aksione me vlerë nominale 1.000 (njëmijë) lekë për aksion. I gjithë kapitali i "Media '99" i përket:

- 1-Nikolle Lesi 800(teteqind) aksione ekuivalente të 40 % të kapitalit të Media "99" të paguara në leke
- 2-Natalina Ucaj 800 (teteqind) aksione ekuivalente të 40 % të kapitalit të Media "99" të paguara në leke.
- 3-Leonard Filopati 400(katerqind) aksione ekuivalente të 20 % të kapitalit të "Media '99" të paguara në leke.

Kapitali fillestar i paguar

Kapitali fillestar i paguar është 2000.000 (dymilion, dhe paguhet prej Aksionerëve Themelues:



1. Nikollë Lesi 800.000 (teteqindmijë) lekë ekuivalent me 40 për qind të kapitalit fillestar.
2. Natalina Ucaj 800.000 (teteqindmije ekuivalent me 40 për qind të kapitalit fillestar.
- 3Leonard Filopati 400000 (katerqindmije)ekuivalent me 20 për qind të kapitalit fillestar.

Neni 7- Mbledhjet e aksionerëve

7.1. Organi kryesor vendimmarrës i "Media '99" është Asambleja e Përgjithshme e Aksioneve (më poshtë referuar si "Asambleja e

Përgjithshme"), e cila përbëhet prej gjithë aksionerëve të "Media '99".

Kompetencat



Leonard Filopati


7.2. Kompetencat e Asamblesë përfshijnë të gjitha kompetencat që i jep asaj Ligji nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", ligji nr.8410 dt.30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat", dhe ky statut.

Mbledhjet e zakonshme

7.3. Asambleja e përgjithshme do të mbajë një Mbledhje të Zakonshme vjetore të aksionerëve të "Media '99" në selinë e saj në RR. "Sami Frashëri" Pallatet e Aviacionit" Tiranë, Shqipëri, ose në një vend tjetër të përcaktuar me vendim unanim të aksionerëve, brenda gjashtë muajve të parë të çdo viti kalendarik, në datën, orën dhe vendin që vendos Drejtoria, për të bërë zgjedhjen e Drejtorëve, anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës dhe kryerjen e të gjitha bizneseve të tjera që gjykohen të arsyeshme t'i shtrohen për zgjidhje. Lajmërimi i mbledhjes që përmban rendin e ditës së saj, kohën dhe vendin ku do të mbahet, do të bëhet nga Drejtori i Drejtorisë me anë të një lajmërimi të botuar në një gazetë të autorizuar për të botuar lajmërimet ligjore ose në mënyrë alternative, me anë të një letre rekomande të dërguar tek secili aksioner i regjistruar që ka të drejtë vote në këtë mbledhje. Lajmërimi duhet të botohet, ose letrat rekomande duhet të merren 15 ditë përpara mbledhjes. Në rast se Drejtori i Drejtorisë refuzon thirrjen e mbledhjes brenda tre ditësh nga marrja e kërkesës, mbledhja mund të thirret nga pala kërkuese.

7.4. Përveç Mbledhjes së Zakonshme vjetore, Drejtoria mund të thërrasë një Mbledhje të Zakonshme të aksionerëve kurdo që ta quaj të arsyeshme. Mbledhja e Zakonshme, mund të thirret nga Eksperti i Autorizuar Kontabël i "Media '99" likujduesi i caktuar të bëjë likujdimet e "Media '99", Këshilli Mbikqyrës, ose mbi bazën e një kërkesë me shkrim të një ose më shumë aksionerëve që kontrollojnë, së bashku, të paktën një të dhjetën e kapitalit të "Media '99" sh.a. Lajmi për thirrjen e Mbledhjes së Zakonshme, në të cilën duhet të përmbahen ora, vendi, rendi i ditës së mbledhjes, do t'i jepet aksionerëve në mënyrën e parashikuar në nenin 7.3. i cili parashikon mënyrën e kryerjes së lajmërimit për Mbledhjet e Zakonshme vjetore.


Mbledhja e Jashtëzakonshme

7.5. Mbledhja e Jashtëzakonshme e aksionerëve mund të thirret në çdo kohë nga Drejtoria. Mbledhja e Jashtëzakonshme mund të thirret me kërkesën e Ekspertit të Autorizuar Kontabël të "Media '99", të likujduesit të caktuar të bëjë likujdimin e "Media '99", të Këshillit Mbikqyrës, ose me kërkesën me shkrim të një ose më shumë aksionerëve që zotërojnë, së bashku, të paktën një të dhjetën e kapitalit të "Media '99". Lajmi për thirrjen e Mbledhjes së jashtëzakonshme, në të cilën do të përmbahen ora, vendi, rendi i ditës së mbledhjes, do t'i jepet aksionerëve në mënyrën e parashikuar në nenin 7.3 i cili parashikon mënyrën e kryerjes së lajmërimit për Mbledhjet e Zakonshme vjetore.

Quorumi dhe marrja e vendimeve në mbledhje

7.6. Në rastin e Mbledhjes së Zakonshme të aksionerëve, quorumi ekziston kur në mbledhje janë të pranishëm aksionerët që zotërojnë të paktën gjysmën e aksioneve. Në rast se nuk arrihet quorumi, mbledhja mund të shtyhet për një moment të dytë jo më vonë se 2 muaj nga data e mbledhjes së parë. Në mbledhjen e dytë nuk ka kërkesë quorumi. Në një Mbledhje të Zakonshme të mbajtur në mënyrën e duhur, vendimet merren me shumicën e votave të aksioneve të përfaqësuara në mbledhje.

7.7. Në rastin e një Mbledhjeje të Jashtëzakonshme, quorumi ekziston kur janë të pranishëm aksionerë që zotërojnë të paktën dy të tretat (2/3) e aksioneve me të drejtë vote. Në rast se nuk arrihet quorumi, takimi shtyhet për një datë tjetër jo më vonë se dy muaj nga data e



Leonard Filopoti
Lhs

takimit të parë. Në Mbledhjen e dytë kërkohet i njëjti quorum. Vendimet në Mbledhjen e Jashtëzakonshme merren me votën pro të tre të katërtave (3/4) të aksioneve të pranishëm ose të përfaqësuara në mbledhje.

7.8. Si në Mbledhjen e Zakonshme dhe në Mbledhjen e Jashtëzakonshme të aksionerëve, çdo aksioner mund të përfaqësojë me prokurë me shkrim jo më shumë se tre aksionerë të tjerë.

7.9. Procesverbalet e mbledhjeve e nënshkruhen nga kryetari i Mbledhjes dhe Sekretari.

Neni 8 - Drejtimi i "Media '99" SH.A.

Drejtoria

8.1. Punët dhe biznesi i "Media '99" sh.a. drejtohen nga Drejtoria icilieshte i zgjedhur nga Këshilli Mbikqyrës për një periudhë katër vjeçare. Sipas Ligjit, Drejtoria është nën kontrollin e mbikqyrjen e Këshillit Mbikqyrës. Këshilli Mbikqyrës mund të vendosë dhënieje shpërblymimi për anëtarët e Drejtorisë në momentin e caktimit të tyre në detyrë.

Drejtor i përgjithshëm i "Media '99" është Enton Abilekaj.

8.2. Në rast të ndonjë vendi bosh në Drejtori si rezultat i vdekjes, dorëheqjes, pushimi, diskualifikimit, ose, ndonjë shkakut tjetër pasardhësit që zënë vendet bosh zgjidhen prej Këshillit Mbikqyrës në një mbledhje që thirret menjëherë pas kësaj ngjarjeje.

Mbledhjet e Drejtorisë

8.3. Mbledhjet e Drejtorisë mund të mbahen një herë në tre muaj, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pjesëmarrja në të cilat mund të jetë personalisht, me lidhje telefonike, me lidhje vizive, teleks, faks, postë elektronike, ose me mjete të tjera të ngjashme elektronike. Mbledhjet e Drejtorisë mbahen me lajmërim ose jo në vendin dhe në orën e caktuar prej Drejtorisë.

8.4. Vendimet në një mbledhje të Drejtorisë në të cilën është arritur quorumi merren me shumicë votash, me përjashtim të rasteve kur me ligj kërkohet një numër më i madh votash pro. Në qoftë se në një mbledhje të Drejtorisë arrihet quorumi, Drejtorët e pranishëm mund ta shtyjnë mbledhjen për një moment të dytë pa njoftime të tjera derisa të arrihet quorumi. Secili prej anëtarëve mund të përfaqësojë me anë të një prokure me shkrim vetëm një anëtar tjetër, përveç vetes së tij.

8.5. Pas Mbledhjes së Zakonshme të aksionerëve, me një njoftim prej 7 ditësh, mbahet mbledhja vjetore e Drejtorisë. Orari dhe vendi i kësaj mbledhjeje vendoset prej Drejtorisë. Në këtë mbledhje, Drejtorët pasi të kualifikohen zgjedhin prej gjirit të tyre një Kryetar të Drejtorisë.

8.6. Çdo vendim i cili lejohet ose kërkohet të merret në një mbledhje të Drejtorisë mund të merret pa organizuar një mbledhje në qoftë se të gjithë Drejtorët që kanë të drejtë të votojnë në mbledhje, e miratojnë unanimisht me shkrim.

Zyrtarët

8.7. Vendimet e përditshme të drejtimit të "Media '99" sh.a. merren prej zyrtarëve, të cilët emërohen prej Këshillit Mbikqyrës dhe mund të përfshijnë Presidentin, dhe / ose Zëvendës Presidentin, Sekretarin, Financierin, dhe të gjithë zyrtarët e tjerë që do të vendosë Këshilli Mbikqyrës. Zyrtarët e "Media '99" sh.a. qëndrojnë në detyra derisa të zgjidhen dhe kualifikohen pasardhësit e tyre. Çdo zyrtar i zgjedhur ose i emëruar nga Këshilli Mbikqyrës



Leonard Floqati
Lfr

mund të shkarkohet në çdo moment me vendim të shumicës të Këshillit Mbikqyrës. Vendet bosh në këto detyra do të plotësohen prej Këshillit të Mbikqyrësve.

Kompetencat e zyrtarëve

8.8. Presidenti. Presidenti është Zyrtari i parë Ekzekutiv i "Media '99" sh.a. merr pjesë në të gjitha mbledhjet e aksioneve dhe Drejtorisë, bën drejtimin efektiv të të gjitha urdhërave dhe vendimeve të Drejtorisë. Presidenti ka të drejtë të përfaqësojë "Media '99" përpara të tretëve dhe për këtë ka kompetencën të nënshkruaj çeqe, urdhëra, kontrata qeraje, lajmërimi, propozime, dhe të gjitha dokumentat që kërkojnë të kenë në të vulën e "Media '99" sh.a. me përjashtim të rasteve kur është e mundur ose e lejuar prej ligjit të nënshkruhen dhe vulosen në mënyrë tjetër dhe me përjashtim të rasteve kur kompetenca për nënshkrimin ose vulosjen i janë dërguar formalisht prej Drejtorisë një zyrtari tjetër të "Media '99". Presidenti kryen të gjitha detyrat e tjera që do t'ia ngarkojë Drejtoria dhe gjatë zhvillimit të punës së përditshme mund të delegojë të gjitha ose një pjesë të kompetencave të tij tek një zyrtar ose zyrtarë të tjerë të "Media '99" sh.a.

8.10. Sekretari. Sekretari, në se ka të tillë, do të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Drejtorisë, Këshillit Mbikqyrës dhe në të gjitha asambltetë e aksionerëve dhe do të mbajë shënime për komitetet e përhershme sipas nevojës. Sekretari mban dhe ruan vulën e "Media '99" dhe ai ose ndihmës Sekretari, kanë të drejtë të vendosin vulën e "Media '99" në të gjitha dokumentat dhe instrumentat që e kërkojnë vënien e saj dhe, një gjë të tillë e vërtetojnë me nënshkrimin e tyre. Drejtoria mund t'i delegojë një zyrtari tjetër kompetencën e vendosjes së vulës dhe vërtetimit të saj me nënshkrimin të tij. Sekretari mban dhe rinovon herë pas here librin zyrtar të aksionerëve.

8.11. Financieri. Financieri mban llogaritë e "Media '99" e të gjitha librat e llogarisë si dhe do të përgatisë raportin financiar vjetor (bilancin, raportin e humbjeve dhe të fitimeve) që do t'i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme pas miratimit nga Drejtoria. Financieri ka kompetencën të përfaqësojë "Media '99" sh.a. pranë bankave, institucioneve financiare, autoriteteve tatimore dhe doganore.

Neni 9-

Këshilli i mbikqyrësve

Përbërja dhe emërimi i anëtarëve të Këshillit të Mbikqyrës

9.1. Këshillim mbikqyrës përbëhet nga tre anëtarë, dy të tretat e të cilëve të zgjedhur nga Asambleja e përgjithshme në mbledhjen e zakonshme vjetore dhe një e treta për punonjësve të "Media '99". Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës emërohen për një periudhë katër vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Mbledhja e Këshillit Mbikqyrës

9.2. Këshilli Mbikqyrës mbledhet rregullisht një herë në tre muaj, ose do të mbledhet në mënyrë të jashtëzakonshme mbi bazën e kërkesës me shkrim të paktën njerit prej anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës. Vendimet merren me shumicën e pjesëtarëve në mbledhje, ku janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve. Nuk pranohen abstenime. Në raste votash të barabarta vota e kryetarit mbizotëron.

Leonard Filipovci
LP

9.3. Këshilli zgjedh nga gjiri i tij një Kryetar, i cili do të drejtojë mbledhjet e Këshillit, dhe një Zëvendës Kryetar, i cili dotë thërrasë mbledhjet. Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit nuk marrin shpërblime shtesë.

9.4. Në përputhje me ligjin, Asambleja e përgjithshme mund të caktojë një shpërblim për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës.

Emërimi i Anëtarëve të Parë të Këshillit Mbikqyrës.

9.5. Në përputhje me nenin 93 të ligjit nr.7638 datë 19.11.1992, në gjendjen aktuale dhe me ndryshimet që mund t'i bëhen për periudhën e parë katër vjeçare, anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë:

z. Kiço Blushi

z. Aleksander Cipa

z.nj Natalina Ucaj

Kompetencat e Këshillit Mbikqyrës

9.6. Këshilli Mbikqyrës ka përgjegjësinë të përcaktojë politikat dhe të mbikqyrë aktivitetin e do të ketë të gjitha kompetencat e parashikuara nga nenet 103, 122, 123, të ligjit nr.7638 datë 19.11.92 në gjendjen aktuale dhe me ndryshimet që mund t'i bëhen.

9.7. Këshilli Mbikqyrës ka përgjegjësinë të sigurojë që të gjitha aktivitetet dhe funksionet e janë në përputhje me ligjin. Këshilli shqyrton dhe mbikqyr të gjitha situatat potenciale ose aktuale të konfliktit të interesave dhe në përputhje me ligjin, merr prej anëtarëve të Drejtorisë të gjitha njoftimet në lidhje me konfliktet aktuale apo potenciale ose interesat materiale që ata mund të kenë me Këshillin Mbikqyrës do të nxjerrë udhëzime në lidhje me ruajtjen e sekretit dhe konfidencialitetit për informacionet në lidhje me si dhe kontrollon zbatimin e tyre.



Neni 10-

Kontabiliteti

10.1. duhet të mbajë llogari të sakta dhe të përgatisë raporte financiare që reflektojnë gjendjen financiare në përputhje me parimet dhe rregullat e kontabilitetit. Raportet e kontabilitetit dhe ato financiare duhet të kenë formën dhe të jenë të detajuara edhe në përputhje me standardet e kontabilitetit të parashikuara me ligj,

Kontrollëret

10.2. Asambleja e përgjithshme në mbledhjen e saj vjetore do të caktojë të paktën dy kontrollorë kontabël të jashtëm, të cilët duhet të jenë ekspertë kontabël të autorizuar. Këta ekspertë do të kenë këto kompetenca: kontrolli dhe mbajtja e llogarive, regjistrimin e operacioneve dhe transaksioneve të vërtetimit në përputhje me legjislacionin në fuqi të raportit dhjetor për gjendjen financiare dhe dhënien e vendimeve për vërtetësinë dhe gjendjen financiare të, informimin e drejtorisë, Këshillit Mbikqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme për çdo parregullsi a të metë të vëzhguar gjatë operacioneve, transaksioneve, procedurave, regjistrimeve, ose llogarive që të mund t'i sjellin asaj humbje materiale, shqyrtimin e përpikmërisë së kontrollit të brendshëm, kontrollin e praktikave dhe procedurave dhe rekomandon përmirësime dhe të gjitha detyrat e parashikuara nga ligji nr.7638 datë 19.11.92 në gjendjen aktuale dhe me ndryshimet që mund t'i bëhen



Leonard Filipov

Emërtimi i Ekspertëve Kontabël

10.3. Shoqëria do të emërojë ekspertët kontabël të autorizuar në përputhje me Nenin 93 të Ligjit nr.7638 datë 19.11.1992, në gjendjen aktuale dhe me ndryshimet që mund t'i bëhen. Eksperti Kontabël i Autorizuar është Luan Kamberi

Neni 11- aksionet

Çertifikatat e aksioneve

11.1. Çertifikatat e regjistrimit do të përfaqësojnë aksionet e "Media '99" sh.a. Çertifikatat do të nënshkruhet nga Presidenti ose Zëvendës Presidenti ose Financieri i shoqërisë dhe mund të vulosen me vulën e "Media '99" sh.a.

11.2. Fimmat e zyrtarëve të shoqërisë në çertifikatë mund të jetë fotokopje në rast se ato kundërfimmosen nga një agjent transferimi ose regjistrohen prej një mbajtësi regjistri të ndryshëm nga vetë shoqëria apo një punonjës i saj. Në rast se firma ose kopja e firmës së një zyrtari është një çertifikatë e lëshuar në momentin kur zyrtari nuk është në atë pozitë ajo lëshohet nga "Media '99" me të njëjtën vlerë.

Çertifikatat e Humbura

11.3. Drejtoria mund të urdhërojë emetimin e një çertifikate të re në vend të ndonjë çertifikate të emtuar nga "Media '99" sh.a. dhe të deklaruar të humbura ose të papërdorshme. Kur bën autorizimin e emetimit të një çertifikate të re Drejtoria mund të parashikojë afate dhe kushte që i quan të nevojshme si dhe mund të kërkojë pagesën e një sasive parash në masën që e gjykon të arsyeshme e cila mund të përdoret si dëmshpërblim ndaj çdo pretendimi që mund të bëhet kundër "Media '99" sh.a. në lidhje me çertifikatën e konsideruar të humbur ose të papërdorshme.

Transferimi i Çertifikatave



11.4. Me dorëzimin në "Media '99" sh.a. ose tek agjenti i transferimit i "Media '99" i një çertifikate të aksioneve të nënshkruara në mënyrën e duhur ose të shoqëruara nga provat e duhura të transferimit, kalimit të pronësisë, ose kompetencën për të transferuar, "Media '99" sh.a. ka për detyrë t'i emetojë një çertifikatë të re personit të titulluar, të shfrytëzojë çertifikatën e vjetër dhe Sekretari do të regjistrojë kryerjen e transaksionit në librat e "Media '99" sh.a.

Përcaktimi i datës së regjistrimit

11.5. Për të bërë të mundur që "Media '99" të përcaktojë personat që kanë të drejtën e lajmërimit dhe të votimit në mbledhjet e aksionerëve, në mbylljet e tyre, për të shprehur miratimin ose kundërshtimin e tyre me shkrim për projekt vendimet e marra pa u organizuar një mbledhje, ose kanë të drejtë të marrin pagesën e dividendit ose shpërndarje të ndonjë të drejte, ose të ndonjë veprimi tjetër, Drejtoria mund të fiksojë më parë një datë për kryerjen e regjistrimeve. Kjo datë nuk mund të vendoset më pak se 10 (dhjetë) ditë dhe më shumë se 50 (pesëdhjetë) ditë përpara kryerjes së ndonjë veprimi tjetër. Kur përcaktimi i numrit të aksionerëve me të drejtë për t'u lajmëruar ose për të votuar në një asamble të aksionerëve është bërë sipas këtij neni, ky numër do të zbatohet edhe në mbledhjet e shtyra, me përjashtim të rasteve kur Drejtoria ka caktuar një datë të re regjistrimi për takimin e shtyrë.

Aksionerët e Regjistruar

11.6. "Media '99" sh.a. ka të drejtë t'u njohë personave të regjistruar në librat e saj të drejtën ekskluzive si pronarë të aksioneve për të marrë dividendët, për të votuar si pronarë, si dhe të jetë e detyruar të përgjigjet për thirrjet dhe rillozaritjet për personat e regjistruar në librat e



Leonard Alojati
Lfu

saj si pronarë të aksioneve, dhe nuk do të jetë e detyruar të njohin ndonjë pretendim ose interes tjetër për këtë aksion ose aksione ndonjë personi të tretë, edhe nëse do të jetë shprehur ose njoftuar lidhur me këtë, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.

Lista e Aksionerëve

11.7. Lista e aksionerëve sipas datës së regjistrimit përgatitet nga Sekretari gjatë mbledhjes ose para mbledhjes me kërkesën e ndonjë aksioneri. Nëse e drejta e votës kundërshtohet në ndonjë mbledhje, inspektorët e zgjedhjes, ose personat që drejtojnë mbledhjen, kërkojnë përgatitjen e listës së aksionerëve që provon të drejtën e personit që i kundërshtohet e drejta e votës në këtë mbledhje. Të gjithë personat që janë në këtë listë si aksionerë mund të votojnë në këto mbledhje të tilla.

E drejta e Parablerjes

11.8. Çdo rast transferimi i aksionerëve nga një aksioner tek një palë e tretë do t'u paraqitet paraprakisht për miratimin aksionerëve të tjerë, aksionerët e tjerë kanë të drejtë të blejnë aksionet e ofruara në të njëjtën çmim blerjeje si pala e tretë, në proporcion me pjesëmarrjen e secilit në kapitalin aksionerëve të tjerë. Aksionerët e tjerë mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes edhe në pjesën tjetër të aksioneve të ofruara dhe të pa blera brenda 7 ditëve prej datës së marrjes së njoftimit. Për qëllim të këtij neni, të gjitha njoftimet bëhen me shkrim via letër rekomande, telefaks ose telegram.

11.9. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen në rast të transferimit të aksioneve nga një aksioner i "Media '99" sh.a. tek një aksioner tjetër i saj. Megjithatë, në këtë rast, transferimi i aksioneve t'i njoftohet paraprakisht me shkrim aksionerëve të tjerë.

11.10. Për tre vitet e para të aktivitetit të "Media '99" duke filluar nga dita e regjistrimit të "Media '99" sh.a. në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Tiranë, aksionerët themelues nuk mund të shesë më shumë se 50 për qind të aksioneve të tij me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 12- Dispozita të përgjithshme



Dividentët

12.1. Dividentët mund të deklarohen, në përputhje me ligjin, prej drejtorisë në cilëndo prej Asambleve të Zakonshme ose të Jashtëzakonshme, Dividentët mund të paguhen me para në dorë, në natyrë, ose me aksione kapitali, ose në letra me vlerë të "Media '99" apo me pasuritë e saj, në përputhje me ligjin.

12.2. Drejtoria, me diskrecionin e saj absolut, herë pas here, përpara pagesës së një dividendi, mund të vendosë mënjane prej fondit të dividendëve atë shumë ose shuma që ajo e mendon të drejtë si një fond rezervë për t'i përdorur për pagesa të paparashikuara ose për të barasvlerësuar dividendë, për të mirëmbajtur dhe riparuar ndonjë pronë të "Media '99" ose për ndonjë qëllim tjetër të cilin Drejtoria e quan të arsyeshme. Drejtoria mund të ndryshojë apo edhe të mbyllë cilindo prej këtyre fondeve rezervë në mënyrën në të cilën u krijuan.

12.3. Viti financiar i "Media '99" sh.a. është viti kalendarik, me përjashtim të rasteve kur Drejtoria vendos ndryshe.

Vula



Leonard Filipovci



12.4. Vula e "Media '99" sh.a. do të ketë shkruar brenda emrin e "Media '99" sh.a., vitin e formimit dhe fjalët "Vula e Shoqërisë". Vula mund të vihet si me anën e presimit (vula e thatë) ose me anën e lënies së gjurmës së saj (vula e njomë) ose më ndonjë mënyrë tjetër riprodhimi.

Neni 13- Ndryshimet dhe shtesat

Ky Statut mund të ndryshohet ose shfuqizohet dhe në vend të tij të miratohet një Statut i ri në një Mbledhje të Jashtëzakonshme në të cilën është arritur qarumi me kusht që në lajmërimin e bërë për mbledhje të jetë përfshirë edhe njoftimi në lidhje me ndryshimin, shtesën apo shfuqizimin.

Neni 14- Shpërndarja dhe /ose Bashkimi

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve në një Mbledhje të Jashtëzakonshme të saj mund të vendosë për mbylljen dhe /ose bashkimin e aktivitetit të "Media '99". Në këtë mbledhje duhet të jetë prezent ose i përfaqësuar qarumi i kërkuar. Vendimi merret me të njëjtin numër votash që duhet në zgjidhjen e Drejtorëve me kusht që në lajmërimin e bërë të përfshihet propozimi i shpërndarjes dhe/ose bashkimit.

Neni 15- Dispozitë përfundimtare


Të gjithë çështjet që nuk janë parashikuar shprehimisht në këtë statut rregullohen nga dispozitat e Ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", në gjendjen aktuale dhe me ndryshimet që mund t'i bëhen. Ky Statut është nënshkruar sot më datë 05.07.1999 prej aksionerëve themelues.

Aksionerët themelues:

1. **Nikoll Lesi**

2. **Natalina Ucaj**

3. **Leonard Filopati**



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERJA TIRANE

NR 3148 REP

NR 237 KCL

Tirane me 15 maj 2000

V E R T E T I M

Sot me dt 15 maj 2000 para meje noteres Manushaqe Sharka me zyre perballe gjykates rrethit Tirane, rruga Zhan Dark u paraqiten kerkuesit :

Nivolle Lesi i paisur me pasaporten nr 0014244.

Natolina Ucaj e paisur me lster njoftimit nr 071028

Leonard Filopati i paisur me pasaporten nr 0943745.

Te tre madhor dhe ne zotasi juridike te plotepur te vepruar.

Ata kerkuan te vertetojne faktin se nenshkrimet e hedhura ne dokumentacionin e shqerise "MEDIA" 09" sh.a, jane te tyret Konform nenit 55 te Ligjit "Mbi Noterine", une noterja i vertetoj ato.

N O T E R E

/ MANUSHAQE SHARKA /

